

## **Procesi i navigimit në certifikatën e vdekjes për ndihmë varrimi nga COVID-19 i ligjit federal për menaxhimin e emergjencës dhe Administratës së Burimeve Njerëzore të NYC**

**Si mund të aplikoj për ndihmë funerali nga COVID-19 i ligjit federal për menaxhimin e emergjencës (Federal Emergency Management Act, FEMA) ose për programet e ndihmës së varrimit nga COVID-19 të Administratës së Burimeve Njerëzore (Human Resource Administration, HRA) të NYC?**

- Për të aplikuar për programin e ndihmës së funeralit nga COVID-19 i FEMA-s, vizitoni faqen [fema.gov/disasters/coronavirus/economic/funeral-assistance](https://www.fema.gov/disasters/coronavirus/economic/funeral-assistance).
- Për të aplikuar për programin e ndihmës së varrimit nga COVID-19 të HRA-së të NYC, vizitoni faqen [www1.nyc.gov/site/hra/help/burial-assistance.page](https://www1.nyc.gov/site/hra/help/burial-assistance.page).

**Si mund të marr certifikatë vdekjeje që tregon shkakun e vdekjes për një person që ka vdekur në NYC?**

Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës Mendore i NYC (Departamenti i Shëndetit të NYC) lëshon certifikata vdekjeje për vdekjet që ndodhin në NYC (Bronx, Brooklyn, Manhattan, Queens dhe Staten Island). Certifikatat e vdekjes janë të disponueshme pas raportimit të vdekjes së personit nga qendra mjekësore dhe pasi ky rast të regjistrohet nga Departamenti i Shëndetit të NYC.

Nëse përfshihet një agjenci funerale, mënyra më e shpejtë për të marrë një certifikatë vdekjeje është që ta porosisni me përgjegjësin e funeralit që merret me organizimin e funeralit. Përgjegjësi i funeralit mund të porosisë certifikata vdekjeje deri në dy vjet pas vdekjes së personit.

Nëse agjencia funerale nuk është përfshirë ende ose nëse nuk keni mundësi ta porosisni certifikatën e vdekjes nga përgjegjësi i funeralit, mund ta porosisni atë edhe në internet, në adresën [vitalcheck.com](https://vitalcheck.com). Vizitoni [faqen e internetit për certifikatat e vdekjes](#) të Departamentit të Shëndetit të NYC për më shumë informacion rreth porositjes së një certifikate vdekjeje.

**Kush ka të drejtë që të kërkojë një certifikatë vdekjeje që tregon shkakun e vdekjes?**

Vetëm të afërmit e mëposhtëm të personit të ndjerë mund të kërkojnë edhe certifikatë vdekjeje, edhe shkakun e vdekjes: Bashkëshorti/bashkëshortja; partneri bashkëjetues; prindi; fëmija; motra/vëllai; gjyshërit/gjyshet; nipat/mbesat; personi njoftues që përmendet në certifikatë; personi përgjegjës për pranimin e të ndjerit

**Sa është tarifa për certifikatën e vdekjes?**

Secila kopje e certifikuar kushton \$15. Kur porosisni një certifikatë vdekjeje në internet, aplikohen tarifa shtesë.

**A do të marr kopje të certifikuar të regjistrimit të vdekjes?**

Po. Departamenti i Shëndetit i NYC do të lëshojë një kopje të certifikuar të certifikatës origjinale të vdekjes. Certifikata e vdekjes e certifikuar nga NYC përfshin disa tipare sigurie, për të garantuar vërtetësinë e certifikatës. Nëse keni të drejtë që të njiheni me shkakun e vdekjes (shihni më lart), do të merrni edhe “Raportin mjekësor konfidencial”, i cili tregon shkakun e vdekjes. Ky dokument tregon gjithashtu emrin e personit të vdekur, numrin e certifikatës së vdekjes dhe printohet në letër të lidhur.

### **Si mund ta kërkoj shkakun e vdekjes nëse ai nuk është përmendur në certifikatën e vdekjes?**

Ju lutemi ta kërkonit shkakun e vdekjes kur të porosisni certifikatën e vdekjes.

### **A ka tarifë të veçantë për shkakun e vdekjes?**

Jo. Nuk ka tarifë shtesë për shkakun e vdekjes.

### **Çfarë duhet të bëj nëse shkakun e vdekjes shfaqet si “i pakonfirmuar”?**

Nëse shkakun e vdekjes shfaqet “i pakonfirmuar”, mund ta zëvendësoni certifikatën e vdekjes brenda tre muajve nga data e lëshimit të certifikatës origjinale të vdekjes. Data e lëshimit është e shënuar në fund të certifikatës së vdekjes. Mund të porosisni gjithashtu në internet një certifikatë vdekjeje të re që tregon shkakun e vdekjes, e cila merret më shpejt se sa ajo që zëvendësohet.

### **Pse shfaqet në certifikatë që shkakun e vdekjes ishte nga shkaqe natyrore kur personi ka vdekur nga COVID-19?**

Në prill të 2020, Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve vendosën që në rastin e vdekjes nga infektimi me COVID-19, mënyra e vdekjes do të jetë pothuajse gjithmonë natyrore.

### **Çfarë duhet të bëj nëse shkakun e vdekjes nuk tregon COVID-19?**

Fillimisht duhet të kontaktoni mjekun ose qendrën mjekësore që certifikoi vdekjen për informacion rreth ndryshimit të shkakut ekzistues të vdekjes, që të tregojë COVID-19 si shkakun kryesor ose shkakun që kontribuoi në vdekje. Nëse jeni personi njoftues i përmendur në certifikatën e vdekjes ose personi përgjegjës për pranimin e të ndjerit, mund të paraqisni një kërkesë te Departamenti i Shëndetit të NYC për të ndryshuar shkakun e vdekjes. Vizitoni [faqen e internetit për korrigjimet në certifikata](#) për udhëzime rreth atyre që ju duhet të paraqitni, te seksioni i pyetjeve, “What is the process to correct a death certificate?” (Cili është procesi i korrigjimit të një certifikate vdekjeje?).

Departamenti i Shëndetit i NYC mund t’i ndryshojë rekomandimet sipas zhvillimit të situatës. **4.11.21**